



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

**FLETË GARANCIE**

EMRI I KLIENTIT:	_____	DATA E BLERJES:	_____
ADRESA / NUMËR	_____		
TELEFONI:	_____	IMEI/ESN/SN:	_____
TIPI, MODELI I PRODUKTIT:	_____		

**NËNSHKRIMI DHE VULA E SHITËSIT TË PRODUKTIT**

\_\_\_\_\_

**GARANCI E KUFIZUAR E OFRUAR NGA PRODHUESI**

Me qëllim lehtësimin e procedurave të garancive të ofruara nga prodhuesit e produkteve dhe për t'i qëndruar sa më afër nevojave të blerësve të paketave të produkteve të blera pranë dyqaneve Telekom Albania, shoqëria jonë, në kuadrin e veprimtarisë së saj në fushën e telefonisë celulare, ju paraqet më poshtë një përmbledhje të kushteve të garancive të ofruara nga prodhuesi përkatës i çdo produkti. Synimi ynë është që ju të orientoheni sa më saktë në lidhje me shërbimet e ofruara pas shitjes së produkteve të blera në dyqanet tona. Telekom Albania ju siguron se gjatë periudhës së garancisë, prodhuesi apo një person fizik/ juridik i autorizuar për shërbimin, do të riparojë në një mënyrë të arsyeshme tregtare defektet në materiale, dizenjim dhe prodhim, falas ose, nëse gjykohet e nevojshme, do të zëvendësojë Produktin në përputhje me këtë Garanci. Kjo Garanci është e vlefshme dhe e zbatueshme vetëm në vendin ku e keni blerë Produktin me kushtin që shitja e Produktit në dyqanin përkatës "Telekom Albania" është kryer në kuadrin e veprimtarisë tregtare të Telekom Albania.

**PERIUDHA E GARANCISË**

Periudha e garancisë fillon në kohën e blerjes së Produktit nga përdoruesi i parë. Produkti mund të përbëhet nga pjesë të ndryshme dhe pjesë të ndryshme mund të mbulohen nga një periudhë garancie e ndryshme.

Periudhat e Garancisë për pajisjet (USB Modem & Fiks GSM me oferte) janë si më poshtë:

a. tridhjetë (30) ditë nga dita e blerjes.

**Shënim:** Në rast se pajisja do të konsiderohet me defekt nga dyqani (nuk punon shërbimi data apo voice) do të zëvendësohet menjëherë me një pajisje të re e cila do të testohet në prani të klientit me kartën SIM të aktivizuar. Sasia e pajisjeve me ofertë është e limituar dhe Telekom Albania rezervon të drejtën të mos e zëvendësojë produktin në rast se nuk ka gjendje në magazinë.



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

Periodha e garancisë nuk do të zgjatet ose rifillojë ose influencohet për shkak të një rishitje pasuese, riparimi të autorizuar ose zëvendësimi të Produktit. Megjithatë, pjesa që riparohet ose produkt i zëvendësuar gjatë periudhës së garancisë do të jetë i garantuar për periudhën e mbetur të Garancisë.

**SI VEPROHET PËR TË MARRË SHËRBIMIN E GARANCISË:**

Nëse ju dëshironi të bëni një kërkesë sipas kësaj Garancie të Kufizuar, ju lutem ktheni Produktin tuaj në dyqanin Telekom Albania që ju ka dorëzuar Produktin pasi e keni blerë atë.

Për çdo kërkesë sipas kësaj Garancie, duhet njoftuar Telekom Albania për çdo defekt të supozuar, brenda një kohe të arsyeshme, nga momenti që defekti është vënë në vëmendjen tuaj dhe në çdo rast jo më vonë se para skadimit të periudhës së garancisë.

Kur bëni një kërkesë sipas kësaj Garancie do të jetë e nevojshme të vini në dispozicion:

- a) Produktin
- b) Dëshmi origjinale të blerjes, që tregon qartë emrin dhe adresën e shitësit, datën dhe vendin e blerjes, llojin e produktit dhe IMEI ose numra serial të tjerë.

**ÇFARË NUK MBULOHET NGA KJO GARANCI:**

1. Kjo GaranCI nuk mbulon manualin e përdoruesit ose ndonjë program të palëve të treta, konfigurime, përmbajtje, të dhënat ose ikona, të përfshira apo të shkarkuara në produkt, gjatë instalimit, montimit, transportit ose në çdo kohë tjetër në zinxhirin e shpërndarjes ose të përfituara prej jush në mënyra të tjera. Telekom Albania nuk garanton, që çdo software do të përmbushë të gjitha kërkesat tuaja, do të punojë në kombinim me ndonjë hardware ose software të siguruar nga një palë e tretë, apo do të funksionojë në mënyrë të pandërprerë dhe pa gabime apo çdo defekt në software është i korrigjueshëm ose do të korrigjohet.
2. Kjo GaranCI nuk mbulon:
  - a) konsumimin normal të pajisjes (duke përfshirë, konsumimin e lenteve të kamerës, baterisë apo ekranit),
  - b) defekte të shkaktuara nga trajtimi pa kujdes (duke përfshirë, defekte të shkaktuara nga sendet e mprehta, nga përkulja, shtypja ose rënia, etj), ose
  - c) defektet ose dëmet e shkaktuara nga keqpërdorimi i produkteve, duke përfshirë përdorimin që është në kundërshtim me udhëzimet e vëna në dispozicion nga Telekom Albania /prodhuesi (p.sh. siç është përcaktuar në manualin e përdoruesit të Produktit) dhe/ose
  - d) akteve të tjera përtej kontrollit të arsyeshëm nga Telekom Albania.
3. Kjo GaranCI nuk mbulon defektet apo defektet e pretenduara të shkaktuara nga fakti që Produkti është përdorur me, apo lidhur me, çdo produkt, aksesori, software dhe/ose shërbime që nuk prodhohen apo furnizohen nga Telekom Albania, apo kur Produkti është përdorur për qëllime të ndryshme nga qëllimi fillestar. Defektet mund të shkaktohen nga viruset, e marra prej veprimeve të përdoruesit ose nga aksesori i paautorizuar i një pale të tretë në shërbimet, llogaritë apo



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

sistemin kompjuterik. Ky akses i paautorizuar mund të realizohet përmes "hacking", "password mining" ose përmes një shumëllojshmërie mjetesh të tjera.

4. Kjo Garanci nuk mbulon defekte të shkaktuara nga fakti se bateria ka rënë në qark të shkurtër ose nga fakti se vulosja e baterisë apo qelizat e saj janë thyer ose tregojnë shenja manipulimi apo nga fakti se bateria ka qenë përdorur në pajisje të tjera përveç atyre për të cilat ajo ka qenë e prodhuar.
5. Kjo Garanci nuk është e ekzekutueshme në qoftë se Produkti është hapur, modifikuar ose riparuar nga ndokush tjetër përveç se në një qendër shërbimi e autorizuar nga Telekom Albania, nëse ajo është riparuar duke përdorur pjesë këmbimi të paautorizuara ose nëse numri serial i Produktit, apo numri i IMEI, janë hequr, fshirë, ndryshuar ose janë të palexueshëm dhe kjo do të përcaktohet nga gjykimi i Telekom Albania.
6. Kjo Garanci nuk është e ekzekutueshme në qoftë se Produkti ka qenë i ekspozuar ndaj lagështisë, njomjes, kushteve ekstreme termike apo të mjedisit ose ndryshimeve të shpejta të këtyre kushteve, gërryerjes, oksidimit, derdhjes mbi Produktin të ushqimit apo lëngjeve ose ndikimit të produkteve kimike.

**NJOFTIME TË TJERA TË RËNDËSISHME**

Ju lutemi, mos harroni të mbani kopje rezervë ose kopje të shkruara të të dhënave të rëndësishme të ruajtura në Produktin tuaj, sepse përmbajtja dhe të dhënat mund të humbasin gjatë riparimit ose zëvendësimit të Produktit. Telekom Albania, në përputhje me dispozitat e nenit titulluar "Kufizimi i Përgjegjësisë së Telekom Albania" më poshtë, në asnjë rrethanë nuk do të jetë përgjegjëse, direkt apo indirekt, për dëmet ose humbjet e çfarëdo lloji që vijnë si rezultat i humbjes, dëmtimit, apo korrupsionit, të përmbajtjes apo të dhënave gjatë riparimit ose zëvendësimit të Produktit.

Të gjitha pjesët e Produktit ose pajisje të tjera që Telekom Albania i ka zëvendësuar do të bëhen pronë e saj. Nëse Produkti nuk është i mbuluar nga termat dhe kushtet e kësaj Garancie, Telekom Albania rezervon të drejtën që në gjykimin e saj të faturojë një tarifë të caktuar për riparimin. Kur Produkti riparohet apo zëvendësohet, Telekom Albania mund të përdorë produktet ose pjesë të cilat janë të reja, ekuivalente me të reja apo të ripërtërirë.

Produkti juaj mund të përmbajë elemente që janë specifike për vendin ku shitet, duke përfshirë edhe programet. Në qoftë se Produkti ka qenë riekportuar nga vendi i tij fillestar drejt një vendi tjetër, Produkti mund të përmbajë elemente specifike për vendin fillestar që nuk konsiderohen defekt sipas kësaj Garancie.

**KUFIZIMI I PËRGJEGJËSISË SË TELEKOM ALBANIA**

Kjo Garanci është mjeti juaj i vetëm dhe ekskluziv kundrejt Telekom Albania dhe përgjegjësia e vetme dhe ekskluzive e Telekom Albania-s në lidhje me defektet në Produktin tuaj. Kjo Garanci e kufizuar zëvendëson të gjitha garancitë e tjera të Telekom Albania dhe detyrimet, qoftë me gojë, me shkrim, kontraktuale, duke përfshirë por pa u kufizuar, në masën që lejohet nga ligji në fuqi, të gjitha kushtet, garancitë apo terma të tjera përsa i përket cilësisë ose përshtatshmërisë për qëllimin e përdorimit të pajisjes.



**TELEKOM ALBANIA SH.A.**

Adresa: Rr. "Vangjel Noti", Laprakë, Tiranë

Megjithatë, kjo Garanci nuk përjashton apo kufizon:

- i) asnjë prej të drejtave tuaja sipas ligjeve të zbatueshme në fuqi apo
- ii) asnjë prej të drejtave tuaja ndaj shitësit të produktit.

Për aq sa lejohet nga ligji në fuqi, Telekom Albania nuk mban përgjegjësi për humbjen apo dëmtimin apo korrupsionin e të dhënave, për çdo humbje financiare, humbjen e përdorimit të Produktit apo funksionalitetit të tij, humbjen e biznesit, humbjen e kontratave, humbje të të ardhurave ose humbje të kursimeve të parashikuara, rritje të kostos apo shpenzimeve ose për ndonjë humbje ose dëmtim të tërthortë, humbje apo dëm të vazhdueshëm apo humbje ose dëmtim të veçantë. Për aq sa lejohet nga ligji në fuqi, përgjegjësia e Telekom Albania do të kufizohet në vlerën e blerjes së produktit.

**SHËNIM!** Produkti juaj është një pajisje elektronike e sofistikuar. Telekom Albania ju inkurajon shumë të familjarizoheni me manualin e përdoruesit dhe udhëzimet e vëna në dispozicion me dhe për Produktin. Ju lutemi vini re se Produkti mund të përmbajë ekran/e me precizion të lartë, lente kamere dhe pjesë të tjera si këto, të cilat mund të gërvishen ose dëmtohen nëse nuk trajtohen me shumë kujdes.